

## **AKTI I THEMELIMIT**

### **I SHOQERISË " R.S.&M " SHPK**

Sot më dt. \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2003 në Tiranë, unë Nikolla Çaci, i biri i Stefanit, d.t. 04.04.1956, lindur ne Gjirokaster dhe banues në Tirane, me zotësi të plotë për të vepruar, Vendosa si ortak i vetëm, të hartoj dhe nënshkruaj Aktin e Themelimit të mëposhtëm për shoqerinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti ë së cilës rregullohet nga statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti themelimi .

#### **Neni 1**

Emërtimi i shoqërisë është " R.S.&M " SHPK .

#### **Neni 2**

Selia e shoqërisë është në KM 2 te Autostrades Tirane-Durres.

#### **Neni 3**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është 99 vjet.

#### **Neni 4**

Objekti i shoqërisë konsiston në :

- Import dhe eksport te materialeve dhe mjeteve te sinjalistikes rrugore, prodhim, montim dhe shperndarje te materialeve dhe mjeteve te sinjalistikes rrugore.
- Vijizime rrugore te akseve rrugore te te gjitha llojeve, kombetare, nderqytetese, lokale dhe rurale.
- Import dhe eksport, montim dhe shperndarje e sisteme hidrosanitare dhe hidraulike.
- Importi dhe eksporti i te gjitha mallrave,produkteve, lendeve te para dhe paisje e makineri,linja prodhimi per perpunimin e lendeve te para te importuara dhe vendase dhe eksport te mallrave te produhuara ,
- Importi dhe eksporti i mallrave industriale, konfeksioneve, materialeve te ndertimit, atyre elektrike, elektroshtepiake, mallrave ushqimore,si dhe cdo malli tjeter te lejuar nga ligji, me shumice dhe pakice .
- Tregetimi me shumice dhe pakice.
- Trasport mallrash brenda dhe jashte vendit me mjetet e vete shoqerise ose te te treteve.

#### **Neni 5**

Administratore e shoqerise do te jetë z. Nikolla Çaci.

#### **Neni 6**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100000(njëqindmijë) lekë, i ndarë në 100 pjesë me vlerë nga 1000(njëmijë) lekë, të cilat i takojnë tërësisht ortakut të vetëm z. Nikolla Çaci, i cili është zotërues i 100% e kapitalit themeltar të shoqërisë.



**Neni 7**

Shoqëria fillon aktivitetin vetëm pas regjistrimit të saj si person juridik dhe në Regjistrin Tregtar.

**Neni 8**

Shoqëria ka të drejtë të hapë filiale, degë e zyra të saj në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj për ushtrimin e aktivitetit.

**Neni 9**

Shoqëria do të paiset me dokumentat përkatëse me regjistrimin e saj pranë organit tativor.

Për veprimtari të veçanta për të cilat legjislacioni kërkon paisjen me licensa të veçanta, veprimtaria e shoqërisë në këto fusha do të fillojë pas paisjes me këto licensa.

**Neni 10**

Fitimi që do të rezultojë pas zbritjes së shpenzimeve të aktivitetit të njoitura me ligji, pas pagesës së detyrimeve tativore si dhe shumës që do të jetë rezervë ligjore, do të disponohet nga ortaku i vetëm.

**Neni 11**

Dispozitat dhe rregullat më të detajuara për funksionimin e shoqërisë janë përcaktuar në statutin e shoqërisë bashkangjitur.

Ortaku i vetëm themelues

Nikolla Çaci

*Nikolla Çaci*

REPUBLICA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
NR 8838 REP NR — KOL

**VËRTETIM**

Sot më dt. 17 / 02 / 2003, para meje noterit KIR QEVANI, në zyrën time u paraqit personalisht Nikolla Çaci, i biri i Stefanit, e dtd. 04.04.1957, lindur ne Gjirokaster dhe banues në Tirane, me zotësi të plotë për të vepruar, te njojur personalisht prej meje, i cili më deklaroi se Akti i Themelimit i shoqërisë " R.S.&M " SHPK, i redaktuar jashtë kësaj zyre dhe i nënshkruar para meje noterit, shpreh vullnetin e lirë dhe të plotë të tij. Sa më sipër në bazë të ligjit unë noteri e vërtetoj dhe nënshkruaj.



**NOTERI**

*Nikolla Çaci*